



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Kryetari i komunës duke u bazuar në strategjinë për riintegrimin e personave të riatdhesuar bënë këtë:

N J O F T I M

Njoftohen të gjithë personat e riatdhesuar të Komunës sonë, që pas arritjes së tyre, të lajmërohen në **Zyrën për kthim dhe komunitete apo në zyrën për integritet evropian** në kuadër të komunës me qëllim të informimit të tyre lidhur me të drejtat dhe mundësitë e tyre në Kosovë njëkohësisht, t'iu jepen udhëzime praktike për atë se cilës zyre t'i drejtoheni për qasje në shërbime publike.

Regjistrimi i gjendjes suaj civile dhe e familjes tuaj është parakusht themelor për qasjen në kujdes shëndetësor, punësim, mirëqenie sociale, pension, pronë dhe shërbime tjera. Andaj, zyra komunale e gjendjes civile është përgjegjëse për regjistrimin e të gjitha lindjeve, martesave, vdekjeve në regjistrat e gjendjes civile dhe do t'iu lëshojë certifikata për gjendjen tuaj civile.

Pasi të pajiseni me certifikatat e tilla, Qendra komunale e regjistrimit civil është përgjegjëse për lëshimin e letërnjoftimit dhe pasaportës.

Po ashtu edhe ju si të gjithë personat tjerë keni të drejtën në kujdes shëndetësor, qasjen në sistemin arsimor, të regjistroheni në zyrën komunale për punësim, përfshirjen në skemat sociale, zgjidhjen e çështjes së banimit etj.

Andaj, për shkak të riintegritetit tuaj sa më të shpejtë në shoqërinë kosovare ju lutem, lajmërohuni në zyrën komunale për kthim dhe komunitete apo në zyrën komunale për integritet evropian, me qëllim të identifikimit të gjendjes dhe nevojave të juaja dhe ofrimit të ndihmës nga ana e zyrtarëve komunal.

Me respekt,

Kryetari i komunës
z. Xhabir Zharku